



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 8143/Prot.

Tiranë, më 07.11.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1621, datë 03.04.2013.

SHOQËRISË “MINERAL FALCON” SH.P.K

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Twin Tower, Kulla 1, Kati 12, Nr.41, Tiranë.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERCJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “MINERAL FALCON” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1621, datë 03.04.2013, për mineralin krom, në Objektivin “Kapit, Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.4474, datë 24.10.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8143, Prot, datë 26.10.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1621, datë 03.04.2013, për mineralin krom, në Objektivin “Kapit, Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, ku nga kontrolli në objekt u konstatua se subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minerar për më shumë se një vit kalendarik dhe nuk ka miratuar planin vjetor të punës.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1621, datë 03.04.2013, për mineralin krom, në Objektivin “Kapit, Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim rreth revokimit të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1621, datë 03.04.2013, për mineralin krom, në Objektivin "Kapit Surrçj", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

